



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:207092

Datë: 19.06.2024

Numri i dokumentit: 05837634

**Ac.nr.8781/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.F., nga fshati B., Komuna e Dragashit, të cilin me autorizim e përfaqëson M.Q., avokat në Prizren, kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike - KEDS Sh.A., me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Malësore Berisha, juriste pranë të paditurës, me objekt kontesti anulim i vendimit për ndërprerjen e kontratës së punës, kthim në vendin e punës dhe kompensimin e pagave, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2592/16, të datës 26.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.06.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** e themeltë ankesa e paditësit M.F., nga fshati B., Komuna e Dragashit, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2592/16, i datës 26.01.2021, në pikën III të dispozitivit, në pjesën ku është vendosur për refuzimin e kërkesës së paditësit për kthim në vendin e punës, ashtu që çështje për këtë pjesë gjykohet si në vijim: **DETYROHET** e paditura Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, me seli në Prishtinë, që paditësin M.F., nga fshati B., Komuna e Dragashit, ta kthej në vendin e punës përgjegjës për operim ose në ndonjë vend tjetër të punës që i përshtatet aftësive profesionale të paditësit, në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

**II. APROVOHET** e themeltë ankesa e paditësit M.F., nga fshati B., Komuna e Dragashit, **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2592/16, i datës 26.01.2021, në pikën III të dispozitivit, në pjesën ku është vendosur për refuzimin e kërkesës së paditësit për kompensimin e të ardhurave personale nga data 30.10.2020, deri në momentin e kthimit të paditësit në punë, dhe për këtë pjesë lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosije.

**III.** Pika I, II, dhe IV e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2592/16, të datës 26.01.2021, mbetet e pashqyrtuar.

### **A r s y e t i m**

Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar C.nr.2592/16, të datës 26.01.2021, ka vendosur si në vijim: “I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit M.F. nga fshati B., Komuna e Dragashit, ashtu që: ANULOHET vendimi i të paditurës KEDS Sh.A., Nr. 439 i datës 27.09.2016, si i kundërligjshëm. II. DETYROHET e paditura KEDS Sh.A., me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të ardhurave personale të pa-paguara t’ia paguaj për periudhën prej 01.12.2016 deri me 30.10.2020 shumë prej 19,510.17 euro neto, si dhe në emër të trustit pensional t’ia paguaj shumë prej 2,166.23 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% e cila llogaritet nga data 30.11.2016 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë. III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadiës me të cilën paditësi ka kërkuar që të kthehet në vendin e punës, si dhe kërkesa që e paditura t’ia kompensoj paditësit të ardhurat personale nga data 30.10.2020 deri në momentin e kthimit të paditësit në punë sipas lartësisë të të ardhurave personale që i takojnë nga vendi i punës, si e pabazuar. IV. DETYROHET e paditura KEDS Sh.A. që paditësit t’ia paguaj shumë prej 888.80 Euro, në emër të shpenzimeve gjyqësore, brenda afatit prej shtatë (7) ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë”.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar në afat ligjor ka parashtruar ankesë, duke e atakuar të njëjtin vetëm në pikën III të dispozitivit, dhe atë për shkelje esenciale të dispozitave procedurale të LPK-së, dhe për aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e paditësit ta aprovon si të bazuar ashtu që aktgjykimin C.nr.2592/16, të datës 26.01.2021, ta ndryshoj vetëm në pikën III në pjesën refuzuese, ashtu që të detyrohet e paditura që paditësin ta kthej në vendin e punës përgjegjës për operim, ose në vend tjetër të punës duke i përshtatur aftësive profesionale të paditësit si dhe të detyrohet e paditura që paditësit t’ia kompensoj të ardhurat personale nga data 30.10.2020, deri në momentin e kthimit të paditësit në punë sipas lartësisë së të ardhurave personale që i takojnë nga vendi i punës, ose që aktgjykimin në pjesën e sulmuar ta prishë dhe çështjen ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në shkresa të lëndës nuk mund të gjendet se e paditura ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarës së tij, me datë 01.11.2016, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, duke kërkuar anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kthimin e paditësit në vendin e punës dhe kompensimin e pagave të porealizuara nga data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës 01.12.2016, e tutje. Pas nxjerrjes së provës me ekspertizë financiare, i autorizuari i paditësit përmes parashtresës së datës 11.01.2021, ka bërë precizimin e kërkesëpadsisë ku përveç kërkesës për anulim të vendimit me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe kthimin e paditësit në vendin e punës përgjegjës për operim ose në vend tjetër duke i përshtatur aftësive profesionale të paditësit, ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën prej 19,510.17 euro neto, në emër të ardhurave personale nga marrëdhënia e punës për periudhën nga data 01.12.2016, deri me datë 30.10.2020, si dhe kontributin pensional në shumë prej 2,166.23 euro në llogarinë e paditësit në trust, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e dorëzimit të padsisë në gjykatë deri në pagesën e plotë, si dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj të ardhurat personale nga data 30.10.2020, deri në momentin e kthimit të paditësit në punë sipas lartësisë së të ardhurave personale që i takojnë nga vendi i punës, si dhe t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore.

Pala e paditur ka paraqitur përgjigje në padi, duke kundërshtuar në tërësi kërkesëpadsinë e paditësit, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padsisë së paditësit dhe precizimit të saj, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.2592/16, të datës 26.01.2021, me të cilin ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadsinë e paditësit duke vendosur me decisivisht si në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetimin e aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar së në mes palëve, nuk ishte kontestues fakti se paditësi ishte i punësuar tek e paditura me kontratë pune me afat të pacaktuar dhe ishte i punësuar për më shumë se dhjetë vite të e paditura (paraardhësja e të paditurës KEK). Nuk ishte kontestues as fakti se e paditura me datën 01.06.2015, paditësin e kishte angazhuar në departamentin për projekte dhe operime në cilësi të përgjegjës për projekte në operim, për kohë të pacaktuar. Kontestuese mes palëve ndërgjyqëse ishte nëse ndërprerja e marrëdhënies së punës së paditësit si rrjedhojë e vendimeve të bordit ekzekutiv të të paditurës ishte e ligjshme. Gjykata ka dhënë vlerësimin se procesi i ristrukturimit të brendshëm të paditurës që ka rezultuar me mbylljen e departamentit për Projekte në Operim dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit, është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Punës. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë e paditura nuk ka arritur të argumentojë se menaxhmenti i KEDS i ka bërë vlerësimet e nevojshme siç ka qenë i autorizuar nga bordi ekzekutiv me vendimin e datës 22.03.2016. Ky fakt është tejet i rëndësishëm për Gjykatën, për të vlerësuar se cilat janë ndryshimet teknike dhe organizative në procesin e punës që kanë krijuar nevojën e strukturës së re organizative, e si rrjedhojë edhe mbylljen e departamenteve tepriçë. Fakti se menaxhmenti i të paditurës nuk ka vepruar sipas vendimit të bordit ekzekutiv të datës 22.03.2019, respektivisht nuk ka përpiluar vlerësimin dhe analizën e autorizuar nga bordi ekzekutiv (për numrin e stafit që duhet të largohet, arsytet për largimin e stafit të caktuar, propozimin për rialokimin deri në masën e mundshme të stafit tepriçë në departamente të tjera

etj.), nënkupton se bordi ekzekutiv vendimin e datës 22.09.2016, e ka marrë në mungesë të një plani të ristrukturimit. Andaj, në mungesë të një analize dhe vlerësimi, siç ka pasur për detyrë të veprohet nga organet e të paditurës, vendimi pasues i bordit ekzekutiv të KEDS, i datës 22.09.2016, sipas vlerësimit të Gjykatës është i kundërligjshëm. Për gjykatën është i paqëndrueshëm fakti i mbylljes së departamenti për projekte dhe operime – pa kriteret e qarta dhe në mungesë të bazës ligjore. Sipas gjykatës, një iniciativë e tillë nuk mund të ndërmerret pa u ndryshuar aktet normative, të cilat kanë epërsi në raport me vendimet e bordit. Gjykata gjen se e paditura nuk ka ofruar prova me të cilat dëshmon se ka bërë ndërhyrje në aktet normative të saj lidhur me ristrukturimin e brendshëm. Gjykata gjeti se mbyllja e një departamenti, ku ishin transferuar me kontrata të reja një grup i punëtorëve të përhershëm – përfshirë edhe paditësin, përmes një vendimi të Bordit të të paditurës, pa u ndryshuar aktet normative të paditurës, është proces jo i rregullt i ri-strukturimit, sipas Ligjit të Punës. Gjykata vëren se e paditura i ka ofruar paditësit kontratë të re të punës – atë të fundit të datës 01.06.2015 dhe e transferon në departamentin për projekte dhe operime - në pozitën “përgjegjës për projekte dhe operim”, edhe pse paditësi kishte kontratë me afat të pacaktuar sipas fuqisë së ligjit. E paditura pas transferimit të paditësit në këtë departament – të njëjtin synon ta mbyllë menjëherë pas një viti - në mars të vitit 2016 me vendimin e bordit të datës 22.03.2019. Ndërsa me vendimin e tjetër të bordit, atë të datës 22.09.2016 përfundimisht e mbyllë këtë departament. Andaj sistemimi i paditësit nga e paditura, në një departament të cilin synon ta mbyll, për gjykatën paraqet shkelje të dispozitave të nenit 17 paragrafi 2 të LP-së, marrë parasysh faktin se e paditura ka pasur për obligim ta ri-sistemoj paditësin si punëtor me kontratë pune me afat të pacaktuar në ndonjë pozitë tjetër që i përshtatet kualifikimeve të tij. Si pasojë e shkeljeve të gjetura nga gjykata në ristrukturimin e paditësit, rrjedhë se edhe vendimi i të paditurës Nr. 439 i datës 27.09.2016 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit duke u bazuar në vendimet e Bordit të dt. 22.03.2016 dhe 22.09.2016, është i kundërligjshëm. Gjykata gjen se vendimi kontestues për ndërprerje e marrëdhënies së punës Nr. 439 i datës 27.09.2016, është i kundërligjshëm, ngase e paditura nuk ka arritur të arsyetojë zbatimin e dispozitës së Nenit 70 par 1 pika 1.1 të Ligjit të Punës, respektivisht se për cilat arsye teknike – organizative është dashur që paditësi të largohet nga puna.

Gjykata duke e vlerësuar edhe kërkesën e paditësit për kompensimin e pagave, si rrjedhojë e largimit të kundërligjshëm nga puna, gjeti se kërkesëpadia në këtë pikë është e bazuar dhe vendosi si në pikën II të dispozitivit, bazuar në nenin 80 parag.1 pika 1.2 të Ligjit të Punës (Ligji Nr. 03/L-212). Gjykata shumë e aprovuar nga pika II e dispozitivit e bazoi në plotësimin e ekspertizës financiare të punuar nga eksperti R.F., të datës 11.01.2021, ku vendosi ta detyrojë të paditurën që paditësit në emër të ardhurave personale të pa-paguara t`ia paguaj shumë prej 19,510.17 euro neto si dhe në emër të trustit pensional t`ia paguaj shumë prej 2,166.23 euro.

Lidhur me pjesën refuzuese të kërkesëpadiës që ka të bëjë me kërkesën e paditësit për kthim në vendin e punës, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se nuk ka bazë ligjore për kthimin e paditësit në vendin e punës tek e paditura. Kjo për shkak se sipas dispozitave ligjore të nenit 80 par.1.2 parashihet se Gjykata mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, që do të thotë vetëm nëse kemi të bëjmë me çështjen e diskriminimit në punë. Në rastin konkret nuk është vërtetuar se ka ekzistuar

ndonjë formë e diskriminimit me rastin e largimit nga puna të paditësit, andaj dhe u vendos si në pikën V. të dispozitiv të këtij aktgjykimi. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh se gjykata nuk aprovoi kërkesën e paditësit për kthim në punë për arsyen e dhënë këtu, u refuzua edhe kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave prej datës 30.10.2020 deri në momentin e kthimit të paditësit në punë. Kjo për shkak se këto dy kërkesa janë të lidhura me njëra tjetrën dhe vetëm në rastin kur do të aprovohej kërkesa për kthimin në punë (kur do të kishte diskriminim), paditësit do të mund t'i takonte edhe kjo e drejtë në kompensim. Për kamatën ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur në kuptim të dispozitës së nenit 452 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar në pjesën në të cilën është goditur me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit për kthim në vendin e punës.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale por edhe sipas pretendimeve ankimore të palës paditëse, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit të atakuar në pikën III të dispozitivit, në pjesën ku është vendosur për refuzimin e kërkesës së paditësit për kthim në vendin e punës, në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale përkatësisht dispozitën e nenit 80 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit të Punës, kur ka vendosur që ta refuzon kërkesën e paditësit për kthim në vendin e punës. Kjo pasi që gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar kërkesën e paditësit për kthim në punë edhe për kundër faktit se ka konstatuar së paditësi ka pasur kontratë pune për periudhë të pacaktuar dhe e ka anuluar si të kundërligjshëm vendimin e të paditurës Nr. 439 i datës 27.09.2016, me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Gjykata e Apelit, nuk pajtohet me vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë së paditësi nuk mund të kthehet në vendin e punës pasi që të njëjtit nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të diskriminimit. Kjo për faktin se nuk ka qenë kontestuese së paditësi ishte i punësuar tek e paditura me kontratë pune me afat të pacaktuar dhe ishte i punësuar për më shumë se dhjetë vite të e paditura duke përfshirë edhe periudhën e punësimit të paraardhësja e të paditurës KEK, ndërsa është vërtetuar së e paditura i ka ofruar paditësit kontratë të re të punës në kohë të pacaktuar – atë të fundit të datës 01.06.2015, dhe e ka transferuar në departamentin për projekte dhe operime - në pozitën “përgjegjës për projekte dhe operim”, edhe pse e njëjta ka pasur për synim ta mbyllë këtë departament. Andaj duke qenë së është vërtetuar së paditësi ka pasur kontratë pune me të paditurën në kohë të pacaktuar dhe të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë joligjore, kjo gjykatë bazuar në nenin 80 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit të Punës, vlerëson së e paditura ka për obligim që paditësin

ta kthej në vendin e punës të cilën e ka ushtruar me parë, ose në ndonjë vend tjetër të punës që i përshtatet aftësive profesionale të paditësit. Kjo pasi që vendosja ndryshe do të përbente diskriminim në raport me paditësit duke marrë parasysh faktin së i njëjti ka qenë i punësuar tek e paditura edhe para se të transferohet në departamentin për projekte dhe operime të cilën e paditura e ka mbyllur pa i plotësuar kërkesat ligjore që dalin nga Ligji i Punës, dhe përveç kësaj është vërtetuar së e paditura nuk ka bërë asnjë përpjekje që paditësin ta sistemoj në ndonjë vend tjetër që i përgjigjet aftësive profesionale të tij. Për këtë arsye kjo gjykatë vendosi që ta ndryshon aktgjykimin e atakuar në pikën III, duke gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e prishur pikën III të aktgjykimin të atakuar në pjesën ku është vendosur për refuzimin e kërkesës së paditësit për kompensimin e të ardhurave personale nga data 30.10.2020, deri në momentin e kthimit të paditësit në punë, pasi që ka gjetur së aktgjykimi atakuar në këtë pjesë është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) e LPK-së, sepse dispozitivi i aktgjykimin në këtë pjesë është i pakuptueshëm dhe rrjedhimisht i pa përmbarueshem. Kjo për faktin së gjykata e shkallës së parë ka vendosur për refuzimin e kërkesës së paditësit për kompensimin e të ardhurave personale nga data 30.10.2020, deri në momentin e kthimit të paditësit në punë sipas lartësisë të të ardhurave personale që i takojnë nga vendi i punës, pa qenë e specifikuar në mënyrë të saktë kërkesa. Kjo pasi që në pikën V të petiumit të parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë është kërkuar kompensimi i të ardhurave personale sipas lartësisë të të ardhurave personale që i takojnë nga vendi i punës, mirëpo nuk është qartësuar së çka nënkupton me pagesën e të ardhurave personale, nëse kjo nënkupton vetëm pagesën e pagës neto, apo edhe kontributin pensional dhe tatimin në pagë, dhe nëse kjo i përfshinë të gjitha atëherë duhet të ceket sa është lartësia e pagës mujore neto, lartësia e kontributit në pagën mujore dhe tatimit në pagë që e kërkon paditësi. Duke e qenë së kërkesa e paditësit në këtë pjesë ka qenë e pakuptueshme, gjykata e shkallës së parë e ka pasur për detyrë që të kërkojë nga paditësi që ta qartësoj/plotësoj kërkesën në kuptim të nenit 99 par.2, 102 par.1, dhe 253 të LPK-së, dhe pastaj të vendosë për kërkesëpadinë e paditësit, pasi që edhe në rastet kur refuzohet kërkesëpadia duhet të dihet në mënyrë të qartë se cila kërkesë është refuzuar. Andaj, për arsyet e cekura si më lartë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pikën III të dispozitivit në pjesën që i referohet kompensimit të ardhurave personale nga data 30.10.2020, deri në momentin e kthimit të paditësit në punë, u deshtë që të priset dhe çështja për këtë pjesë të kërkesëpadisë të kthehet në rigjykim, ngase gjykata e shkallës së dytë në mungesë të qartësisimit të saktë të kërkesës nuk ka pasur mundësi që të njëjtin ta ndryshoj.

Në riprocedurë, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që të bëjë eliminimin e shkeljeve të sipër theksuara, ashtu që fillimisht të thërras paditësin qa ta bëjë të qartë kërkesën e tij lidhur me pjesën për të cilën është prishur aktgjykimi, dhe pas qartësisimit të kërkesës të caktoj seancën e shqyrtimit kryesor dhe t'i administroj provat që kanë të bëjnë me vërtetimin e fakteve relevante, dhe duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të vendos për këtë pjesë të kërkesëpadisë së paditësit.

Aktgjykimi i atakuar ka mbetur i pashqyrtuar në pikat I, II, dhe IV, kjo pasi që asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimin e në lidhje me këto pika të dispozitivit.

Numri i lëndës: 2019:207092  
Datë: 19.06.2024  
Numri i dokumentit: 05837634

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika c) dhe e), vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.8781/2021, datë 10.06.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari  
Hysni Bardheci